

**BULETINI MBI RREZIQET NATYRORE** (*Bulletin on Natural Hazards*)**Qendra Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore**Facebook page : [Instituti i Gjeoshkencave](#), Webpage: [www.geo.edu.al](http://www.geo.edu.al)**Buletini Nr. 03 / 2025, 03-01-2025****Parashikimi** nga 03-01-2025 ora 12:00 deri 04-01-2025, ora 23:59.**DËBORA DHE NGRICA**  
-----

Sot pasdite (e premte, dt. 03) dhe nesër (e shtunë, dt. 04) reshjet e dëborës priten të përfshijnë zonat Verilindore dhe Lindore të territorit. Reshjet e dëborës të pasuara nga ulja e ndjeshme e temperaturave dhe ngricat mund të krijojnë probleme të ndryshme dhe vështirësi në transportin rrugor.

**PARASHIKIMI METEO**  
-----**RESHJET**

Sot pasdite (e premte, dt. 03) dhe nesër (e shtunë, dt. 04) priten reshje intensive deri lokalisht shumë intensive në qarkun Shkodër. Në qarqet Kukës, Dibër, Lezhë, Durrës, Tiranë dhe Elbasan priten reshje mesatare deri lokalisht intensive. Në qarqet Berat dhe Vlorë reshjet priten të jenë mesatare ndërsa në Fier, Korçë, dhe Gjirokastrë reshjet priten të jenë të dobëta deri lokalisht mesatare. Reshjet do të shoqërohen me shtrëngata në të gjithë vendin (siç tregohet në tabelë, respektivisht për secilin qark). Në Verilindje dhe Lindje në lartësitë mbi 800 m nga niveli i detit reshjet do të jenë në formë dëbore.

Shtrëngatat dhe intensiteti i lartë i reshjeve, për momente të shkurtra, mund të krijojnë probleme të ndryshme, si dhe vërshime të ujit në zonat urbane, në varësi të sistemit të kanalizimeve në qarqet Shkodër, Kukës, Dibër, Lezhë, Durrës, Tiranë dhe Elbasan.

**TEMPERATURA**

Nesër (e shtunë, dt. 04) temperaturat minimale dhe maksimale të ajrit priten të arrijnë:

në bregdet: 5 / 13 °C

në vendet e ulëta: 2 / 13 °C

në vendet malore: -3 / 7 °C

**ERA**

Sot pasdite (e premte, dt. 03) era pritet të fryjë mesatare deri e forë ndërsa nesër (e shtunë, dt. 04) era pritet të fryjë e lehtë deri mesatare.

**NIVELET E RREZIKUT****S'KA RREZIK****I ULËT****I MODERUAR****I LARTË**

Instituti i Gjeoshkencave – IGJEO

Operator Florinda Tuga

Koordinator: Elona Abazi ( Tel: +355 69 311 9392, e-mail: [albania.hazards@gmail.com](mailto:albania.hazards@gmail.com))

faqe 1 / 3

**BULETINI MBI RREZIQET NATYRORE** (Bulletin on Natural Hazards)













Qendra Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore

Facebook page : Instituti i Gjeoshkencave, Webpage: [www.geo.edu.al](http://www.geo.edu.al)

Buletini Nr. 03 / 2025, 03-01-2025


Parashikimi nga 03-01-2025 ora 12:00 deri 04-01-2025, ora 23:59.

**PARASHIKIMI I DETAJUAR MBI RREZIQET NATYRORE (SOT DHE NESËR)**

RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT	Zjarre në pyje	Ngjarje Meteorologjike			Ngjarje Hidrologjike		
	Zjarret Mesatarja e qarkut	Reshje 24-orëshe Mesatarja e qarkut	Reshje 24-orëshe Maksimale të lokalizuara	Shtrëngata	Përmbytje të Shpejta	Përmbytje Lumenjsh	Rrëshqitje toke
<b>SHKODËR</b>	S'KA RREZIK	intensive	shumë intensive				
<b>KUKËS</b>	S'KA RREZIK	mesatare	intensive				
<b>DIBËR</b>	S'KA RREZIK	mesatare	intensive				
<b>LEZHË</b>	S'KA RREZIK	mesatare	intensive				
<b>DURRËS</b>	S'KA RREZIK	mesatare	intensive				
<b>TIRANË</b>	S'KA RREZIK	mesatare	intensive				
<b>ELBASAN</b>	S'KA RREZIK	mesatare					
<b>FIER</b>	S'KA RREZIK	të dobëta	mesatare				
<b>BERAT</b>	S'KA RREZIK	mesatare					
<b>KORÇË</b>	S'KA RREZIK	të dobëta	mesatare				
<b>VLORË</b>	S'KA RREZIK	mesatare					
<b>GJIROKASTËR</b>	S'KA RREZIK	të dobëta	mesatare				

**LEGJENDA: Reshjet 24-orëshe**

<b>Niveli i Rrezikut</b>	<b>Reshje shiu (mm / 24 orë)</b>
<b>S'KA RREZIK</b>	të dobëta (0 – 15 mm / 24 orë) Nuk priten fenomene hidro-meteorologjike problematike.
<b>I ULËT</b>	mesatare (15 – 45 mm / 24 orë) Mundësi që të shfaqen fenomene hidro-meteorologjike problematike.
<b>I MODERUAR</b>	intensive (45 – 90 mm / 24 orë) Moti parashikohet i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonta hidro-meteorologjike.
<b>I LARTË</b>	shumë intensive (> 90 mm / 24 orë) Moti është shumë i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonshme hidro-meteorologjike mjaft intensive.



**RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT për sot dhe nesër, dt. 03 – 04.01.2025.**

**LEGJENDA: Zjarre në pyje**

<b>S'KA RREZIK</b>	Zjarret e mundshëm janë të kontrollueshëm lehtësisht.
<b>ULËT</b>	Barërat e thatë dhe pyjet mund të digjen lehtë. Flakët janë të mesme në pyje dhe të shpejta në zonat e ekspozuara.
<b>I MODERUAR</b>	Ndezja e zjarreve mund të ndodhë lehtë dhe me përhapje të shpejtë. Zjarret mund të jenë shumë të nxehtë, me kurora përhapje të vogla dhe të mesme.
<b>I LARTË</b>	Ndezja mund të shkaktohet edhe nga një shkëndijë. Zjarret janë shumë të nxehtë me përhapje shumë të shpejtë të flakëve si rrjedhim kontrolli i tyre është shumë i vështirë.

**SIMBOLE**

	Shtrëngata: reshje mbi 20 mm/3orë. Moti mund të krijojë probleme të ndryshme
	Përmbytje urbane ose nga përrrenjtë dhe lumenjtë e vegjël
	Përmbytje nga lumenjtë e mesëm dhe të mëdhenj
	Rrëshqitje toke